

Albanska/Shqip

Ekzaminim për kujtesën

Juve ju është dërguar një thirrje për të filluar nje ekzaminim për kujtesën. Kjo për arsye sepse ju ose ndonjë i afërm i juaj mund të keni vënë re shqetësime lidhur me kujtesën tek ju dhe që mund të shkaktohet nga arsye të tjera që nuk kanë lidhje me atë që quhet "harresë normale".

Të gjithë mund të harrojnë ndonjëherë por me kalimin e moshës rritet rreziku i prekjës nga sëmundja e harresës. Aktualisht mundësia e kurimit për këtë sëmundje nuk ekziston por ekzistojnë trajtime mjekësore për ta lehtësuar atë.

Ju do t'i nënshtroheni nje ekzaminimi për të parë nëse jeni prekur nga sëmundja e harresës ose nëse shqetësimet me harresën kanë të bëjnë me ndonjë gjë tjetër qe mund të trajtohet.

Për të shqyrtuar këtë gjë, ju do t'i nënshtroheni disa ekzaminimeve dhe testeve kujtese. Gjatë ekzaminimeve ju do të konsultoheni me një mjek dhe një infermiere.

Të merrni me vete një të afërm ose një mik të afërt që ju njeh mirë juve është dicka që mund t'ju bëjë të ndiheni i sigurt dhe është e rëndësishme edhe për ne gjatë ekzaminimit.

Që të mund ta kryejmë ekzaminimin sa më të mirë , duhet të dimë sa më shumë të jetë e mundur rreth jush dhe shqetësimeve tuaja në jetën e përditshme. Prandaj ne do t'ju bëjmë pyetje juve dhe personit të afërt që ju shoqëron. Gjatë ekzaminimit do të bëjmë edhe teste të ndryshme, të masim tensionin e gjakut dhe të bëjmë teste bazë për kujtesën.

Që të arrijmë në rezultate sa më të sakta, dëshirojmë që testet të kryhen në gjuhën që ju zotëroni më mirë. Ne ju sigurojmë gjithmonë përkthyes.

Mos harroni të merrni me vete një listë aktuale të ilaceve por edhe syze dhe aparat dëgjimi nëse ju përdorni të tilla.

Svenska

Minnesutredning

Du har fått en kallelse att påbörja en minnesutredning. Detta kan bero på att Du eller någon anhörig märkt av minnesbesvär hos Dig som skulle kunna bero på annat än normal glömska.

Alla kan vi vara lite glömska ibland men ju äldre vi blir desto större är risken att drabbas av en demenssjukdom. Det finns idag ännu ingen bot mot demens men däremot finns det symptomlindrande behandlingar

Du kommer att genomgå en utredning för att se om det är en demenssjukdom Du har drabbats av eller om Dina minnesbesvär skulle kunna bero på något annat som går att behandla.

För att ta reda på detta kommer Du att genomgå en del undersökningar och minnestester. Under utredningen kommer Du att få träffa en läkare och en sjuksköterska.

Att ha med sig en anhörig eller nära vän som känner Dig väl kan kännas tryggt för Dig och är även en viktig del för oss i utredningen.

För att kunna utreda Dig på bästa sätt behöver vi få veta så mycket som möjligt om Dina besvär och Din vardag. Därför kommer vi att ställa en del frågor till Dig och Din anhörig. Under utredningens gång kommer vi även att ta en del prover, mäta blodtrycket och genomföra grundläggande minnestester.

För att få ett så bra resultat som möjligt vill vi att Du utför testerna på det språk som Du behärskar bäst. Vi anlitar alltid tolk.

Tänk på att ha med Dig aktuell läkemedelslista och även glasögon och hörapparat om Du använder det.